




KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Nr. Prot.

Tiranë, më 26 Tetor 2022

Drejtuar: Znj. A Sh
Kryetare
Kolegji i Posaçëm i Apelit

Znj. P Q
Kryetare/Komisionere
Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
Rruga Kavajës, ish-godina e "Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve"



Nga: Znj. E S
Drejtoresh Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Lënda: Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të kopjes së dokumentacionit

E nderuar Znj. Sh

E nderuar Znj. Q

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) në ushtrim të misionit për të kontribuar për respektimin e të drejtave të njeriut dhe forcimin e shtetit të së drejtës, ka patur në fokus të veprimtarisë, ngritjen dhe funksionimin e institucioneve përgjegjëse të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në vendin tonë (njohur ndryshe si *vetting*) por edhe institucioneve të tjera të sistemit të ri të drejtësisë.

Një nga rekomandimet më të rëndësishme të Komisionit Evropian në raportin për Shqipërinë gjatë vitit 2021 është i lidhur me subjektet të cilat i nënshtrohen procesit të *vetting*-ut, ku kërkohet që të sigurohet në mënyrë të qëndrueshme dhe sistematike, procedimi penal ndaj këtyre subjekteve nëse ka fakte apo indicje që krijojnë dyshime të bazuara për kryerjen e veprave penale, të zbuluara fillimisht nga hetimi administrativ në kuadër të procesit të *vetting*-ut. Gjithashtu, Komisioni Evropian vendos theksin tek hetimi pasuror gjatë hetimit penal për veprat penale në ngarkim të tyre si dhe sekuestrimin e pronave të subjekteve të rivlerësuara, nëse ekzistojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale apo ligjin e ashtëquajtur "anti-mafia".

KShH vëren se procesi i *vetting*-ut, pavarësisht rëndësisë, nuk do të mundësonte arritjen e qëllimit madhor të kthimit të besimit të shtetasve në sistemin e drejtësisë, nëse nuk do të alternohej me veprimtarinë e institucioneve të tjera të sistemit të drejtësisë të cilat garantojnë hetimin dhe ndëshkimin penal të subjekteve të *vetting*-ut, në përputhje me legjislativonin e ri të sistemit të drejtësisë. Si rrjedhojë, impakti i procesit të *vetting*-ut, i cili ka një natyrë administrative është njëkohësisht i mbështetur me vulln dhe kompetencat e Prokurorisë së Përgjithshme dhe funksionit të Përgjithshëm.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Për efekte studimore nga KShH si një organizatë jofitimprurëse e pavarur, sa i takon impaktit që ka patur procesi i vettingut në veprimtarinë e organeve të sistemit të drejtësisë penale të ngarkuara në hetimin dhe gjykimin e veprave penale, përfshi këtu veprat penale në fushën e korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe ato të kryera nga subjektet e posaçme, si dhe duke patur në konsideratë bashkëpunimin konstruktiv që kemi patur me Institucionet që Ju drejtoni për aktivitete me rëndësi të zbatimit të deritanishëm të reformës në drejtësi, do të vlerësonim angazhimin Tuaj, bazuar edhe në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", për tu informuar si vijon:

1. Sa gjyqtarë dhe prokurorë janë shkarkuar në periudhën Janar 2021 – Tetor 2022, me vendim të KPK apo vendim të formës së prerë të KPA-së? Cilat janë pozicionet që ata kanë mbajtur në sistemin gjyqësor dhe të prokurorisë?
2. Sa gjyqtarë dhe prokurorë janë dorëhequr brenda të njëjtës periudhë? Cilat janë pozicionet që ata kanë mbajtur në sistemin gjyqësor dhe të prokurorisë?
3. A ka pasur raste kur organi që Ju drejtoni apo anëtarë të tij kanë referuar apo kallëzuar pranë Prokurorisë së Posaçme apo ato të Juridiksionit të Përgjithshëm, fakte që janë zbuluar gjatë procesit të rivlerësimit që përbëjnë vepra penale që ndiqen kryesisht, në zbatim të nenit 281, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale? KShH kërkon të njihet me kopje të dokumentacionit, me anë të të cilit është bërë ky referim.
4. A ka patur raste kur prokuroritë në fjalë janë vendosur në lëvizje me inisiativë (ex officio), në kushtet kur procesi i vettingut ka karakter publik? KShH kërkon të njihet me kopje të dokumentacionit (nëse dispononi) ku ndërmerret nisma nga prokuroritë në fjalë, në korrespondencën që mund të kenë patur me ju, për këtë periudhë?
5. Në kuadër të pikave 3 dhe 4 si më sipër, a ju është komunikuar nga këto prokurori nevoja për dokumentacion shtesë lidhur me këto subjekte apo çdo kërkesë apo komunikim tjetër zyrtar prej tyre në funksion të mbarëvajtjes së hetimeve (KShH kërkon të njihet me kopjen e dokumentacionit nëse dispononi)?

Sa më sipër, me qëllim përpunimin e të dhënave cilësore dhe statistikore, në mënyrë objektive dhe të qartë KShH do të vlerësonte ofrimin e informacionit të ndarë sipas pikave të sipërpërmendura, brenda afateve ligjore të parashikuara në ligjin 119/2014. Për lehtësi dhe ekonomicitet vlerësojmë edhe dërgimin elektronik të përgjigjeve, në adresën elektronike të stafit zbatues të projektit

Nëse institucioni që Ju drejtoni ndodhet në pamundësi objektive për të mbledhur dhe përpunuar të dhënat e kërkuara, KShH merr përsipër të paguajë koston e dokumentacionit të disponuar ku administrohet informacioni i kërkuar, me qëllim përpunimin e mëtejshëm të tij nga vetë stafi i KShH-së.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm!

Mbetemi në pritje të një përgjigje nga ana juaj.

Me konsideratë,

Drejtori (Dëshmorët)